

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË - Departamenti për Krime të Rënda, në trupin gjykues të përbërë Nikollë Komani, kryetar i trupit gjykues, Besarta Doli dhe Drilon Haraçia anëtar të trupit gjykues, me sekretaren juridike Mandushe Doli, në lëndën penale kundër të akuzuarit S. M. nga Rahoveci, për shkak të veprës penale konflikti i interesit nga neni 424 par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Gjakovë PP/I nr. 3/2017 të datës 13.06.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor më datë **29.09.2017**, në prezencën e prokurorit Agron Matjani, përfaqësueses së autorizuar të dëmtuarës Komuna Rahovec, F. K., të akuzuarit S. M. dhe mbrojtësit të tij M. B. avokat në Rahovec, të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **S. M.**, i biri i B. dhe M., e gjinisë Sh., data e lindjes..., në Rahovec, ku edhe tani banon në rr..., i gjendjes së mesme ekonomike, ka të kryer fakultetin e ndërtimtarisë, i martuar, atë i tre fëmijëve, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse në periudhën kohore prej vitit 2013 gjerë në fillim të vitit 2016 i akuzuari S. M. si person zyrtar shef në Drejtorinë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit pranë KK Rahovec, e ka keqpërdorur detyrën zyrtare me qëllim të fitimit të dobisë pasurore të kundërligjshme për vete në atë mënyrë që përfiton nga qytetarët pasi që projektet ideore, kryesore para llogarit ka realizuar ai vetë personalisht përmes ndërmarrjes së tij “V.” SH.P.K. Rahovec, që është e regjistruar në ARBK- me numër të biznesit ..., në emrin e bashkëshortes A. M. me pozitë Drejtore, i akuzuari është inxhinier i kësaj ndërmarrje, i njëjti ka realizuar 21 projekte në emër të ndërmarrjes së tij “V.” SH.P.K. Rahovec, duke i llogaritur dhe pagesat për këto projekte e që pastaj kanë kaluar nëpër duart e tij duke i punuar si të rregullta në Drejtorinë e Urbanizmit, Planifikimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

- me çka ka kryer veprën penale konflikti i interesit nga neni 424 par.1 të KPRK-së.

Gjykata në bazë të nenit 6, 7, 17, 41, 43, 46, 73, 424 par. 1 të KPRK-së dhe nenit 233 dhe 365 të KPP-së, ia shqipton:

D Ë N I M I N M E G J O B Ë

Në shumën prej 1100,00 € (njëmijë e njëqind euro) të cilin dënim është i detyruar ta paguaj në dy këste dhe atë kësti i parë në shumën prej 500,00 € (pesë qind euro) do të paguhet deri me datën 05, të muajit të parë nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit dhe kësti i dytë në shumën prej 600,00 € (gjashtë qind euro) do të paguhet deri me datën 05, të muajit të dytë nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nëse i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë, i njëjti i zëvendësohet me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 55 (pesëdhjetë e pesë ditëve) duke ia llogaritur **20,00 €**, për një ditë burgimi.

Detyrohet i akuzuari që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale në shumën prej 60,00 € në afatin prej 15 ditëve nga dita e plotëfuqishmerisë së aktgjykimit.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore ne Gjakovë-Departamenti për Krime të Rënda me aktakuzën PP/I nr. 3/2017 të datës 13.06.2017, ka akuzuar S. M. nga Rahoveci, për shkak të veprës penale keqpërdorim i pozitës zyrtare apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar seancën për shqyrtimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë ku prezentë kanë qenë prokurori Agron Matjani, përfaqësuesja e autorizuar e të dëmtuarës Komuna e Rahovecit F. K., i akuzuari S. M. dhe mbrojtësi i tij M. B avokat në Rahovec.

Me marrëveshjen PP/I nr. 3/2017 të datës 13.06.2017, e lidhur në mes të prokurorit, të akuzuarit S. M. dhe mbrojtësit të tij, fillimisht është bërë rikualifikimi i veprës penale nga vepra penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-së, në veprën penale konflikt interesi nga neni 424 par. 1 të KPRK-së dhe ka propozuar që kjo marrëveshje të aprovohet.

Prokurori Agron Matjani gjatë seancës ka deklaruar se me të akuzuarin dhe mbrojtësin e tij sipas autorizimit të Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjakovë kanë arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë sipas së cilës marrëveshje është bërë rikualifikimi i veprës penale nga vepra penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-së, në veprën penale konflikt interesi nga neni 424 par. 1 të KPRK-së.

Përfaqësuesja e autorizuar e të dëmtuarës Komuna Rahovec, F. K. pasi është njoftuar me marrëveshjen e arritur dhe i është dorëzuar një kopje e marrëveshjes ka theksuar se nuk e kundërshton marrëveshjen e arritur në mes të prokurorit dhe mbrojtjes.

Mbrojtësi i të akuzuarit S. M., avokati M. B. ka theksuar se e mbështet në tërësi marrëveshjen e arritur dhe pajtohet me propozimin e prokurorit që kjo marrëveshje të aprovohet.

I akuzuari S. M. ka theksuar se e pranon në tërësi fajësinë për veprën penale konflikt interesi nga neni 424 par. 1 të KPRK-së dhe pajtohet me marrëveshjen e arritur.

Gjykata pas dëgjimit të pretendimeve të prokurorit, përfaqësueses së të dëmtuarës, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij, lidhur me marrëveshje për pranim të fajësisë ka konstatuar se i akuzuari S.M., e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë sipas marrëveshjes, pranimi i fajësisë mbështet në faktet dhe provat që i janë bashkangjitur aktakuzës, si dhe nuk ekziston asnjëra nga rrethanat për hudhjen e aktakuzës dhe pushimin e procedurës penale të parapara me nenin 253 par.1 dhe 2 të KPP-së, andaj gjykata ka konstatuar se marrëveshja mbi pranimin e fajësisë ka mbështetje ligjor dhe është e bazuar në nenin 233 par. 21 të KPP-së dhe gjykata ka pranuar marrëveshje për pranimin e fajësisë.

Gjatë seancës për përcaktimin e dënimit prokurori Agron Matjani ka deklaruar se mbetet pranë dënimit të propozuar me marrëveshjen për pranimin e fajësisë që për veprën penale konflikti i interesit nga neni 424 par. 1 të KPRK-së, ti shqiptohet dënimi me gjobë në shumën prej 1000,00 € deri në 1200,00 €.

Përfaqësuesja e autorizuar e të dëmtuarës F. K. ka theksuar se nuk e kundërshtuar lartësinë e dënimit të propozuar sipas marrëveshjes ndërsa sa i përket kompensimit të dëmit ka theksuar se pasi nga aktakuza nuk vërehet se Komuna Rahovec është e dëmtuar, nuk parashtrajnë kërkesë pasurore juridike.

Mbrojtësi i të akuzuarit avokati M. B. ka theksuar se i propozon gjykatës që të akuzuarit ti shqiptohet minimumi i dënimit sipas marrëveshjes së dënimit dhe atë dënim me gjobë në shumën prej 1000,00 € si dhe ka propozuar që bazuar në nenin 46 par. 2 të KPRK-së, ky dënim të paguhet në këtë pasi i akuzuari është ushqyes-mbajtës i familjes e ku tërë familja jetojnë nga të ardhurat personale që realizon i akuzuari në shumën prej 430,00 €.

I akuzuari S. M. ka theksuar se mbetet pranë marrëveshjes dhe dënimit të propozuar në marrëveshje.

Gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin dhe llojit të tij, gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të paraparë me nenin 73 të KPP-së, të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit. Si rrethanë rënduese për të akuzuarin gjykata ka konstatuar se i akuzuari ka qenë i dënuar për veprën penale të natyrës së njëjtë sipas aktgjykimit PKR.nr. 48/17 të datës 18.05.2017 dhe atë dënim me gjobë në shumën prej 1000,00 € ndërsa si rrethana lehtësuese për të akuzuarin ka marrë parasysh pranimin e fajësisë, sjelljen korrekte faktin se i akuzuari është mbajtës i familjes pesë anëtarësh, ku vetëm i akuzuari është i punësuar dhe tre fëmijët i ka student e të cilat rrethana lehtësuese kanë ndikuar që gjykata ta aprovoi marrëveshjen për pranimin e fajësisë dhe të akuzuarit S. M. të ja shqipton dënimin sipas marrëveshjes së arritur dhe atë dënim me gjobë në shumën prej 1100,00 €, me bindjen e plotë se ky dënim është në harmoni me peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë së të akuzuarit dhe se gjykata është e bindur se me dënimin e shqiptuar ndaj të akuzuarit do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 41 të KPRK-së.

Vendimi që e dëmtuara Komuna Rahovec të mos udhëzohet në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike është marrë pasi përfaqësuesja e autorizuar e dëmtuarës gjatë seancës ka deklaruar se nuk kërkojnë kompensim dëmi.

Vendimi për shpenzimet e procedurës penale është marrë bazuar në nenin 450 par. 1 dhe 2 nën par. 2.6 të KPP-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
PKR. nr. 65/17 datë 29.09.2017

Sekretarja Juridike
Mandushe Doli

Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari
Nikollë Komani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin prej 15 ditëve nga dita e marrjes së tij, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmes të kësaj gjykate.